



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Shqyrtimi i Pestë i Tarifave të Energjisë Elektrike (ShTE5) 2011-2012

**Shqyrtimi i komenteve, përgjigjet dhe propozimi i
ZRRE-së**

Prishtinë, 13 prill 2011

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje	2
1 Hyrja.....	3
2 Komentet e KEK-ut dhe përgjigjet e ZRRE-së.....	4
2.1 Humbjet e lejuara komerciale	4
2.2 Mospërfshirja e kostove të sigurimit për furnizimin e KEK-ut	6
2.3 Të hyrat e shërbimeve ndihmëse	6
2.4 Rregullimi për opexin e pashpenzuar në veri të Lumit Ibër	6
2.5 Miratimi i tarifës së rregulluar 220kV.....	6
3 Bashkërenditja e kostove të importit	7
4 Llogaria Balancuese e Tarifave	7
5 Komentet e KOSTT-it	9
5.1 Kufiri Tavan i propozuar i të Hyrave	9
5.2 Humbjet e transmisionit.....	10
5.3 Kapitalizimi i mirëmbajtjes	11
5.4 Kostot e personelit	12
5.5 Kostot e shërbimeve ndihmëse	13
5.6 Shpenzimet tjera të përgjithshme	14
5.7 Financimi i shpenzimeve kapitale.....	14
6 Subvencionet e importit	15
7 Përmbledhja e propozimeve	15
Shtojca 1: Tabelat e tarifave	17
Tarifat e rregulluara të KEK-ut	17
Shtojca 2: Ngarkesat e KOSTT	18

Përmbledhje

- Palët e interesuara që kanë dorëzuar komente për Raportet Konsultative të ZRRE-së janë KEK sh.a., KOSTT sh.a. dhe NewCo Ferronikeli Complex sh.p.k.
- ZRRE-ja i ka shqyrtuar të gjitha komentet e pranuar. Pas shqyrtimit, ZRRE-ja propozon që të Hyrave të Lejuara në Raportin Konsultativ t'u bëjë përshtatjet në vijim:
 - Të lejojë kostot e sigurimit për Furnizimin e KEK-ut, duke rritur të Hyrat e Lejuara të KEK-ut për 0.756 milionë euro.
 - Të pranojë kërkesën e KOSTT-it për shpenzimet e tjera operative, me kusht që shpenzimet për shpronësime të kapitalizohen.
 - Të zbresë kostot e shërbimeve ndihmëse nga të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it, meqë këto nuk kanë gjasë të paguhen, duke ulur të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it për 1.6 milionë euro dhe duke rritur ato të KEK-ut për të njëjtën shumë.
 - Të bashkërendisë ndryshimin në mes të importit të lejuar dhe atij të realizuar në vlerë prej 10 milionë eurosh.
- Përveç kësaj, ZRRE-ja ka përditësuar të Hyrat e Lejuara të paraqitura në Raportin Konsultativ për të pasqyruar shkallën e subvencioneve të importit të përfshira në Buxhetin e Republikës së Kosovës (BRK) prej 27.35 milionë eurosh për vitin 2011 krahasuar me 33.05 milionë euro të parashikuara në Raportet Konsultative.
- Duke pasur parasysh se të Hyrat që KEK-u pritet t'i mbledhë nga tarifat aktuale të rregulluara janë më të larta se të Hyrat e Lejuara të paralogaritura për KEK-un, ZRRE-ja vazhdon të propozojë që të mos bëhet asnjë ndryshim në tarifat e rregulluara ekzistuese me pakicë. Ndryshimi në mes të të Hyrave që do të mblidhen nga tarifat e tanishme të rregulluara dhe të Hyrave të Lejuara do të alokohet në Llogarinë Balancuese të Tarifave (LBT).
- ZRRE-ja propozon që të ulen tarifat e KOSTT-it në përputhje me uljen e propozuar në të Hyrat e Lejuara.

1 Hyrja

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e Shqyrtimit të Pestë të Tarifave të Energjisë Elektrike (ShTE5). Shqyrtimi do të përcaktojë nivelin e tarifave të rregulluara nga të Hyrat e Lejuara të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK) dhe të Operatorit të Transmisionit, Sistemit dhe Tregut të Kosovës sh.a. (KOSTT).

Renditja kronologjike e ngjarjeve në lidhje me ShTE5 jepet më poshtë:

- 30 dhjetor 2010 – ZRRE-ja dërgon Letrën e Parimeve dhe Orarit
- 06 janar 2011 – ZRRE-ja dërgon modelet e aplikacionit tarifor në KEK dhe KOSTT
- 28 janar 2011 – Të licensuarit dorëzojnë aplikacionet e tyre për të Hyrat e Lejuara dhe Tarifat
- 22 shkurt 2011 – ZRRE-ja publikon Raportet Konsultative (ndarazi për KEK-un dhe KOSTT-in).

Raportet Konsultative kanë paraqitur pikëpamjet e ZRRE-së për aplikacionet tarifore të të licensuarve dhe propozimin e ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara dhe Tarifat. Qëllimi i Raporteve Konsultative ishte që të pranohen komente eventuale nga palët e interesit me pikëpamjet dhe propozimet e ZRRE-së. Palët që kanë dorëzuar komente para skadimit të afatit janë:

1. Korporatata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK)
2. Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut i Kosovës sh.a. (KOSTT)
3. NewCo Ferronikeli Complex sh.p.k. (Ferronikeli)

Komentet e pranuar janë publikuar në uebfaqen e ZRRE-së.

Ky dokument paraqet përgjigjet e ZRRE-së në komentet që janë pranuar. Këto përgjigje do të pasqyrohen në vendimet përfundimtare për tarifat e rregulluara dhe ngarkesat.

Komentet që janë marrë nga Ferronikeli kishin të bënin vetëm me propozimet e KEK-ut për tarifën e rregulluar për furnizim në 220kV. Meqë KEK-u i është përgjigjur gjithashtu komenteve të ZRRE-së për këtë tarifë të propozuar, komentet e të dyja palëve, Ferronikelit dhe KEK-ut, janë trajtuar së bashku në këtë Raport.

Pas publikimit të Raporteve Konsultative, Buxheti i Republikës së Kosovës (BRK) për vitin 2011 është miratuar në Kuvend. Subvencionet e importit të përfshira në BRK-në e miratuar nga Kuvendi ndryshojnë nga supozimet e përdorura nga ZRRE-ja në parallogaritjet e saj të të Hyrave të Lejuara të përfshira në Raportet Konsultative. Këto llogaritje janë përshtatur në mënyrën e duhur.

2 Komentet e KEK-ut dhe përgjigjet e ZRRE-së

Në përgjigjet e tyre, KEK-u kanë deklaruar se pajtohen me shumicën e propozimeve të ZRRE-së të paraqitura në Raportin Konsultativ. Megjithatë, KEK-u ka kontestuar disa rregullime të bëra nga ZRRE-ja, të cilat janë renditur më poshtë:

- humbjet e lejuara komerciale;
- mospërfshirja e kostove të sigurimit për Furnizimin e KEK-ut;
- përfshirja e të Hyrave për Shërbimet Ndihmëse;
- rregullimi për shpenzimet operative të pashpenzuara (opex) në veri të Lumit Ibër;
- kërkesa për tarifë të rregulluar për shërbimin në 220 kV. Ferronikeli gjithashtu ka dhënë komente në lidhje me këtë tarifë;
- nevoja për Llogarinë e propozuar balancuese të tarifave.

2.1 Humbjet e lejuara komerciale

Në propozimet e saj të dhëna në Raportin Konsultativ, ZRRE-ja ka vendosur që për qëllim të llogaritjes së të Hyrave të Lejuara të SHTE5, të lejojë nivelin e humbjeve prej 20% (duke përfshirë humbjet nga furnizimi në zonat dhe enklavat e minoriteteve) dhe jo 22.4% sa është kërkuar nga KEK-u. Në komentet e tyre në Raportin Konsultativ, KEK-u është duke kërkuar nga ZRRE-ja që të eliminojë "reduktimin arbitrar dhe të paarritshëm" të humbjeve komerciale dhe të caktojë shkallën e humbjeve të lejuara komerciale në 18%, me furnizimin në zonat në veri të lumit Ibër që i shtohen kësaj për të dhënë totalin e kërkuar prej 22.4% humbje. KEK-u gjithashtu ka argumentuar se ZRRE-ja e kishte miratuar më parë (në nëntor 2010) Bilancin e Energjisë për vitin 2011 në të cilin janë lejuar humbjet në nivel 22.4%.

Siç ka vënë në dukje KEK-u në komentet e tyre, e-maili i dërguar nga ZRRE-ja në lidhje me Bilancin e Energjisë për vitin 2011 kishte përfshirë formulimin në vijim: "*Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ... i ka dhënë një miratim me vërejtje ... duke sugjeruar që humbjet komerciale dhe energjia në enklava të mos kalojë vlerën e 20.1% të energjisë në hyrje të distribucionit*". KEK-u e ka interpretuar këtë se do të thotë se bilanci ishte miratuar ashtu si ishte dorëzuar, me sugjerimin që nuk ka qenë pjesë e miratimit.

ZRRE-ja konsideron që KEK-u e ka keqkuptuar si pozicionin ligjor të ZRRE-së në lidhje me Bilancin e energjisë ashtu dhe korrespondencën e ZRRE-së për këtë çështje. Miratimi i Bilancit të Energjisë bëhet nga Ministria përgjegjëse për energji (më herët Ministria për Energji dhe Miniera). Miratimi i ZRRE-së është dhënë për dorëzimin e Bilancit të Energjisë të propozuar në Ministri, i shoqëruar nga sugjerimi i ZRRE-së që vlera e humbjeve komerciale dhe energjia e furnizuar në enklavat serbe në Bilancin përfundimtar të miratuar duhet të jetë gjithsej 20.1% e energjisë që hyn në shpërndarje.

Komentet e KEK-ut dhe përgjigjet e ZRRE-së

Emaili i ZRRE-së, i cituar nga KEK-u, nuk paraqet aprovimin nga ZRRE-ja as të Bilancit të Energjisë e as pajtimin e ZRRE-së për vlerën e propozuar për humbjet komerciale të përfshirë në draft Bilancin e Energjisë.

Ministria më pas ka lëshuar miratimin e saj kushtëzues, duke kërkuar që Bilanci Energjetik të përfshijë sugjerimin e ZRRE-së për shkallët e humbjeve.

ZRRE-ja dëshiron ta bëjë të qartë se niveli i humbjeve komerciale i përcaktuar në kuadër të llogaritjes së të Hyrave të Lejuara të SHTE5 është në të njëjtin nivel përqindjeje sa ka qenë në të gjitha shqyrtimet e kaluara tarifore dhe përfshin edhe humbjet komerciale siç përkufizohen nga KEK-u edhe furnizimet e pafaturuara në zonat e minoriteteve. Pavarësisht faktit se shkalla e furnizimeve të pafaturuara ka shënuar rënie, ZRRE-ja nuk e ka përshtatur nivelin e humbjeve të lejuara komerciale për ta pasqyruar këtë. Rrjedhimisht, shkalla efektive e lejuar e humbjeve komerciale ka qenë në rritje. ZRRE-ja po ashtu nuk i ka ulur edhe normat e humbjeve komerciale në përqindje për shkak të rritjes së konsumit, edhe pse mund të pritet që normat duhet të biejnë ndërkohë që vëllimi i energjisë rritet. Figura 1 tregon shkallët e lejuara të humbjeve komerciale gjatë 3 shqyrtimeve tarifore të fundit. Siç paraqitet në diagram, duke lejuar të njëjtën shkallë humbjesh komerciale çdo vit (20%), ZRRE-ja i ka mundësuar KEK-ut që të inkasojë një rritje në volume të humbjeve komerciale në vitin 2010 prej 12.8% krahasuar me vitin 2009.




Figura 1: Humbjet e lejuara komerciale (2009, 2010, 2011)

ZRRE-ja thekson se rritja e nivelit të humbjeve të lejuara do të shërbente si masë dekurajuese për KEK-un që të vazhdojë të ulë humbjet në rrjetin e shpërndarjes. Për këtë arsye, me qëllim të llogaritjes së të Hyrave të Lejuara në kuadër të SHTE5, ZRRE-ja do të lejojë nivelin e humbjeve komerciale, duke përfshirë furnizimin e pafaturuar në zonat e pakicave, në 20%.

2.2 Mospërfshirja e kostove të sigurimit për furnizimin e KEK-ut

KEK-u ka kërkuar që ZRRE të rishikojë mospërfshirjen e kostove të sigurimit në Divizionin e Furnizimit. ZRRE konfirmon se mospërfshirja e kësaj kostoje nuk ka qenë e qëllimshme. Rrjedhimisht ZRRE do të rrisë të Hyrat e Lejuara të KEK-ut për vlerën prej 0.7 milionë euro.

2.3 Të hyrat e shërbimeve ndihmëse

ZRRE-ja pajtohet se KEK-u nuk pritet të marrë ndonjë pagesë për shërbimet ndihmëse gjatë vitit 2011 dhe që të Hyrat e parregulluara për KEK-un duhet të përshtaten në mënyrë të duhur (shih Nenin 5.5 të këtij raporti). Kjo përshtatje e ZRRE-së do të rrisë të Hyrat e Lejuara të KEK-ut për 1.6 milionë euro dhe do të zvogëlojë ato të KOSTT-it për një shumë ekuivalente. Kjo ndërhyrje e ZRRE-së nuk ka ndikim në tarifën mesatare të energjië elektrike.

2.4 Rregullimi për shpenzimet operative të pashpenzuara në veri të Lumit Ibër

KEK-u ka kontestuar vendimin e ZRRE-së për tërheqjen e 3 milionë eurove dhëna në kuadër të të Hyrave të Lejuara të SHTE4 për shkak se këto të Hyra nuk ishin shpenzuar për rregullimin e furnizimit në Veri. Argumenti i KEK-ut është niveli i këtyre të Hyrave është më i ulët sesa humbja e të Hyrave që do të mund të mblihdeshin nga rregullimi i furnizimit në Veri dhe se këto shpenzime do të realizohen në vitin që vjen.

KEK-u nuk ka ofruar fakte që do të bindnin ZRRE-në se këto të Hyra do të shpenzohen në vitin që vjen. ZRRE-ja gjithashtu konsideron se KEK-u nuk duhet të kompensohet për dështimin në rregullimin e furnizimeve. Kjo do të implikonte që konsumatorët e tjerë të paguajnë KEK-un për dështimin e tij për të rregulluar të gjitha furnizimet me energji elektrike.

Komenti i KEK-ut nuk e ka ndryshuar qëndrimin e ZRRE-së për përshtatjen në lidhje me shpenzimet operative të pashpenzuara të paraqitura në Raportin Konsultativ.

2.5 Miratimi i tarifës së rregulluar 220kV

Së bashku me këtë Raport, ZRRE-ja ka publikuar një raport të veçantë Konsultativ për tarifën e rregulluar që do të zbatohet për shitje nga KEK-u për Ferronikelin, në bazë të supozimit se konkurrenca efektive nuk ekziston dhe, për këtë arsye, duhet të aplikohet tarifë e rregulluar.

Për qëllime të llogaritjes së të Hyrave të Lejuara që do të nxirren prej tarifave të rregulluara, siç janë paraqitur në këtë raport, ZRRE-ja ka bërë supozimet e mëposhtme:

- Ferronikeli do të furnizohet me tarifën e rregulluar.

Bashkërenditja e kostove të importit

- Tarifa mesatare e rregulluar e aplikueshme do të jetë rreth 4.14 €/kWh¹.

3 Bashkërenditja e kostove të importit

ZRRE-ja cakton kostot e lejuara të të licencuarve në mënyrë ex-ante. Kudo që kostot e realizuara ndryshojnë në mënyrë ekscesive nga kostot e lejuara, ZRRE i bashkërenditë ato në shqyrtimin vijues tarifor.

Në kuadër të të Hyrave të Lejuara të SHTE4, ZRRE kishte lejuar KEK-un të mbulojë kostot e blerjes së importit në vlerë prej 59.7 milionë eurosh, duke supozuar se vëllimi i energjisë së importuar do të ishte 859.9 GWh, ndërsa çmimi mesatar i importit do të ishte 69.5 €/MWh. Në aplikacionin tarifor KEK-u ka raportuar se gjatë vitit 2010 ka importuar vetëm 684.4 GWh me çmim mesatar prej 57.9 €/MWh. Si rezultat, kostoja e blerjes së energjisë nga importi për KEK-un ka qenë rreth 20 milionë euro më e ulët krahasuar me koston e parashikuar:

Tabela 1: Kostoja e importit

KOSTOJA E IMPORTIT		ETR4 Lejuar	ETR4 Realizuar	Ndryshimi €000s
Kostoja mesatare e importit	€/MWh	69.50	57.91	
Vëllimi i importuar	GWh	859.90	685	
Gjithsej	€000	59,763.05	39,664.37	20,099

Kostoja mesatare e importit kryesisht është jashtë kontrollit të ndërmarrjeve të energjisë dhe varet nga tregu i energjisë elektrike në rajon. Megjithatë, rritja e besueshmërisë së kapaciteteve gjeneruese vendore i ka mundësuar KEK-ut që të parashikojë në afat më të gjatë kohor blerjen e energjisë nga importi dhe kjo mund të ketë pasur ndikim në rënien e çmimit të importit. ZRRE do të lejojë KEK-un të mbajë gjysmën e ndryshimit në Tabelën 1 si nxitje për të vazhduar uljen e kostove të importit, në krahasim me koston e tyre sikur kjo energji të blihej në kontrata më afatshkurtëra.

4 Llogaria Balancuese e Tarifave

KEK-u pajtohet me konceptin e Llogarisë Balancuese të Tarifave (LBT), i cili ishte paraqitur nga ZRRE-ja në Raportin konsultativ. Megjithatë, KEK-u thekson se kjo është e parëndësishme për qëllimet e këtij shqyrtimi tarifor meqë parallogaritjet e KEK-ut janë se të hyrat në bazë të tarifave të tanishme janë më pak se të Hyrat e Lejuara. Prandaj, nuk ka asnjë ndryshim pozitiv ndërmjet të hyrave të pritshme dhe atyre të lejuara që do të shtohen në LBT.

¹ Tarifa mesatare varet, ashtu si për konsumatorët tjerë, në supozimet rreth faktorit të ngarkesës (kërkesa në raport me energjinë aktive) së Ferronikelit.

Llogaria Balancuese e Tarifave

Në llogaritjet e tyre, KEK-u vë në dukje që ZRRE-ja rezulton të ketë projektuar të hyra sipas tarifave të tanishme duke përdorur tarifën mesatare të lejuar për vitin 2010 (5.59 €/kWh) dhe duke supozuar se kjo vlen për të gjithë konsumatorët e rregulluar. Megjithatë, Ferronikeli ka qenë më parë konsumator i parregulluar dhe, si konsumator i rregulluar, tarifa mesatare e tij do të ishte më e vogël se tarifa mesatare e rregulluar e të gjithë konsumatorëve të vitit 2010. Llogaritja e ZRRE-së, për këtë arsye, mbivlerëson të Hyrat që pritet të mblidhen nga tarifat e tanishme të vitit 2011.

ZRRE-ja ka rillogaritur të Hyrat që pritet të mblidhen në vitin 2011 sipas tarifave të tanishme sipas parimeve të mëposhtme:

- Tarifa mesatare e rregulluar në vitin 2010, prej 5.59 €/kWh, është supozuar që të vazhdojë të aplikohet për të gjithë konsumatorët të cilët janë furnizuar në tarifën e rregulluar në vitin 2010. Të Hyrat nga këta konsumatorë janë llogaritur duke përdorur këtë tarifë mesatare dhe parallogaritjet e ZRRE-së të shitjeve të këta konsumatorë në vitin 2011.
- Të Hyrat nga Ferronikeli në vitin 2011 janë llogaritur duke përdorur tarifën e supozuar mesatare prej 4.14 €/kWh, dhe parallogaritjen e ZRRE-së dhe të KEK-ut të shitjeve të Ferronikeli në vitin 2011.

Të Hyrat rezultuese të parallogaritura të KEK-ut në vitin 2011 janë 191.3 milionë euro. Kjo krahasohet me të Hyrat e Lejuara (pas rregullimeve të propozuara në këtë raport, përfshirja e informatave për subvencionet e importit dhe heqjes së importeve të lejuara) prej 180.3 milionë eurosh.

Diferenca prej 11.0 milionë eurosh do të alokohet në Llogarinë Balancuese të Tarifave (LBT-së).

Bilanci i kësaj llogarie do të përshtatet për të marrë parasysh interesin, në të njëjtën mënyrë si përshtatjet e tjera të deritanishme. Në vitin vijues tarifor, LBT-ja do të jetë në dispozicion dhe, sipas vlerësimit të ZRRE-së, mund përdoret për të zbutur rritjet e menjëhershme të tarifave. Çdo pjesë e papërdorur e LBT-së apo çdo shtesë e LBT-së, si pasojë e vendimeve të ZRRE-së, do të bartet në vitet e ardhshme tarifore.

Tabela 2: Vlerësimi paraprak i Llogarisë Balancuese të Tarifave

LLOGARIA BALANCUESE E TARIFAVE	Tarifa €/kWh	Shitjet GWh	Të Hyrat €000
Konsumatorët ekzistues të rregulluar	5.59	2,922.05	163,265.72
Ferronikeli	4.14	678.28	28,077.74
Gjithsej	5.31	3,600.33	191,343.46
Të Hyrat e Lejuara			180,328
Llogaria Balancuese e Tarifave (LBT)			11,016

5 Komentet e KOSTT-it

Komentet specifike të KOSTT-it në lidhje me Raportin Konsultativ të ZRRE-së janë fokusuar në këto çështje:

- propozimi i ZRRE-së për të Hyrat tavan;
- humbjet e transmisionit;
- kapitalizimi i mirëmbajtjes;
- kostot e personelit;
- kostot e shërbimeve ndihmëse;
- shpenzimet tjera të përgjithshme;
- financimi i shpenzimeve kapitale.

5.1 Kufiri Tavan i propozuar i të Hyrave

Për ShTE5, ZRRE-ja ka propozuar që të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it, duke përjashtuar humbjet, të vendosen si “të Hyra Tavan” ku të Hyrat e Lejuara për KOSTT-in do të kufizoheshin në të Hyrat e Lejuara që janë përdorur për të përcaktuar nivelin e tarifave. Çdo ndryshim në mes të të Hyrave të realizuara dhe atyre të lejuara do të përshtatej në bashkërenditjet e të Hyrave në vitet e mëvonshme. Ky propozim është bërë pas mosmarrëveshjeve që kanë lindur në mes të KEK-ut dhe KOSTT-it në vitet e mëparshme, ku vëllimet e energjisë në transmision kanë tejkaluar pritjet dhe, si rezultat, kanë bërë që KEK-u t’i paguajë KOSTT-it shuma që kanë tejkaluar vlerat e parashikuara në të Hyrat e Lejuara.

KOSTT-i e ka pranuar këtë problem në aplikacionin e tyre. Megjithatë, komentet në përgjigje të Raportit Konsultativ të ZRRE-së e bëjnë të qartë se KOSTT nuk është dakord me përgjigjen e propozuar të ZRRE-së. KOSTT-i jep dy argumente:

- Metodologjia Tarifore tashmë përfshin kufirin (tavanin) e të Hyrave për KOSTT-in dhe KEK-un.
- Vëllimet aktuale në 2011 do të tejkalojnë ato të projektuara në Bilancin e Energjisë dhe të llogaritura nga ZRRE-ja për qëllime të përcaktimit të të Hyrave të Lejuara. Duke pasur parasysh këtë, si KEK-u ashtu edhe KOSTT-i do të nxjerrin të Hyra që tejkalojnë nivelet e përcaktuara nga ZRRE-ja.

KOSTT nuk ka dhënë ndonjë arsye për pohimin se vëllimet e realizuara të energjisë elektrike në vitin 2011 do t’i tejkalojnë ato të parashikuara në Bilancin Energjetik. Pohimi i KOSTT-it është i papritur kur merret parasysh fakti se është përgjegjësi e KOSTT-it që të përgatisë Bilancin e Energjisë dhe se deri në përpilimin e komenteve të tyre kanë kaluar vetëm 3 muaj nga i tërë viti kalendarik. Nëse vlerat e Bilancit të Energjisë janë nënvlerësuar, atëherë kjo do të rezultojë në tarifa më të larta meqë të Hyrat

Komentet e KOSTT-it

pjesëtohen me emërues më të vogël. Për më tepër, KOSTT-i do të ishte në gjendje të mblidhte më shumë të Hyra për shkak të rrjedhës më të lartë në të njëjtin vit. Në mënyrë që të parandalohet mbikompensimi i të Hyrave dhe të mbahen kostot brenda kufinjve të lejuar, është e arsyeshme që të aplikohet një kufi(tavan) i të Hyrave maksimale që mund të mblidhen nga KOSTT-i.

ZRRE-ja konsideron se përcaktimi i të Hyrave të KOSTT-it si të hyra tavan, të barabarta me nivelin e të Hyrave të Lejuara duhet të implementohet në këtë shqyrtim tarifor. Ky kufi do të zbatohet duke bërë rregullimet në të Hyrat e Lejuara në vitet e mëvonshme.

5.2 Humbjet e transmisionit

Sipas KOSTT-it, norma e përqindjes së humbjeve të lejuara për rrjetin e transmisionit në vitin 2011 nuk duhet të vendoset në nivele të barabarta me nivelin e humbjeve aktuale të vitit 2010. Argumenti i KOSTT-it është që ndryshimi në mes të Humbjeve të realizuara dhe atyre të lejuar nuk duhet të hiqet plotësisht, në mënyrë që të shpërblehet KOSTT-i për reduktimet e arritura në vitin 2010 dhe, në këtë mënyrë, të sigurojë stimulim për KOSTT-in për të ulur më tej humbjet në të ardhmen. KOSTT-i pohon se ky argument bazohet në parimin e "rregullimit të bazuar në stimulim", parim i cili është vendosur në Metodologjinë Tarifore.

ZRRE-ja e thekson se niveli i humbjeve në sistemin e transmisionit ka rënë ndjeshëm gjatë viteve të fundit, pjesërisht për shkak të matjeve të përmirësuara, pjesërisht për shkak të programeve efektive dhe intensive të investimeve të paguara nga konsumatorët.

ZRRE-ja ofron stimulime për reduktime të vazhdueshme të humbjeve duke i lejuar KOSTT-it që të mbajë përfitimin nga këto reduktime. Në rastet kur humbjet bien ose rriten për shkak të ndryshimeve në vëllime nga ato që janë parashikuar në kohën e përcaktimit të tarifave të rregulluara, ZRRE-ja rregullon të Hyrat në vitet e mëvonshme për të kompensuar diferencën rezultuese në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të humbjeve të transmisionit. Kjo do të thotë që KOSTT-i nuk përfiton apo humb nga ndryshimet në koston e humbjeve në rastet kur këto ndryshojnë për shkaqe që janë jashtë kontrollit të KOSTT-it. Megjithatë, ZRRE-ja nuk bën asnjë rregullim në rastet kur kostoja aktuale e humbjeve ndryshon nga nivelet e lejuara për shkak të ndryshimeve në shkallën e përqindjes së humbjeve, e cila konsiderohet të jetë nën kontrollin e KOSTT-it. Për këtë arsye, KOSTT-i mban përfitimin nga reduktimi i humbjeve (diferencën midis kostove të lejuara të humbjeve dhe kostove aktuale) në vitin kur kjo ndodh për shkak të ndryshimeve në shkallën e përqindjes së humbjeve.

Ky stimulim nuk ndikon në nivelin e humbjeve të lejuara për vitin aktual tarifor, pasi kanë ndodhur reduktime të tilla. Ky nivel caktohet nga ZRRE-ja në bazë të vlerësimit të saj në lidhje me atë se çfarë nivelesh të humbjeve janë të arritshme. Norma e realizuar e humbjeve në vitin 2010 është një normë që duhet gjithashtu të jetë e arritshme nga KOSTT-i në vitin pasues.

Komenti i KOSTT-it nuk ka ndryshuar pikëpamjet e ZRRE-së për nivelin e lejuar të humbjeve në ShTE5.

5.3 Kapitalizimi i mirëmbajtjes

KOSTT-i pretendon që ZRRE-ja ka qenë jokonsistente në shqyrtimet tarifore në trajtimin e saj të mirëmbajtjes së kapitalizuar. KOSTT-i pretendon se vlera prej 5.1 milionë eurosh e mirëmbajtjes së kapitalizuar në vitin 2009 ka mbetur e pazgjidhur dhe kërkon nga ZRRE-ja që ta përfshijë këtë vlerë në shpenzimet kapitale për vitin 2011.

ZRRE-ja thekson se nuk do të lejojë KOSTT-in të kompensohet dy herë për të njëjtën kategori të kostos. Kostot e mirëmbajtjes mbledhen njëherë përmes shpenzimeve të lejuara operative. Nëse ato përfshihen më pas në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB), kjo do të nënkuptonte se këto shpenzime do të nxirren përsëri përmes kostove të zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar. Megjithatë, ZRRE-ja gjithashtu e pranon se është e udhës që disa shpenzime për rinovim, që aktualisht konsiderohen si shpenzime të mirëmbajtjes, të kapitalizohen meqë ato e kanë efektin e zgjatjes së jetëgjatësisë së asetit dhe të rritjes së kapacitetit të tyre. Megjithatë në këto raste, ZRRE-ja duhet të korrigjojë për vlerën që është transferuar në RAB në shqyrtimin pasues tarifor.

Në vitin 2009, shpenzimet e realizuara të mirëmbajtjes të KOSTT-it ishin dukshëm më të vogëla se ato të lejuara nga ZRRE-ja. KOSTT-i ka shpjeguar se ndryshimi ishte kapitalizuar. Sikur ZRRE-ja të mos kishte bërë asnjë rregullim për këtë, konsumatorët do të kishin paguar dy herë për këto kosto – njëherë përmes tarifave të rregulluara për vitin 2009 që i kanë përfshirë ato si shpenzime operative dhe përsëri në vitin 2010 dhe në vitet pasuese përmes RAB.

Meqë KOSTT-i e ka sqaruar këtë situatë vetëm pas ngjarjes, ZRRE-së i është dashur të vendosë nëse rregullimi duhet të bëhet përmes rregullimeve të shpenzimeve operative apo RAB-it (dhe lejimit të zhvlerësimit të ndërlidhur dhe kthimit). Duke pasur parasysh implikimet e rëndësishme të rrjedhës së parasë për KOSTT-in nga bërja e rregullimit përmes shpenzimeve operative (d.m.th., zbritja e shumës së plotë të mirëmbajtjes së kapitalizuar nga të hyrat e lejuara në vitin 2010), ZRRE-ja ka zgjedhur që të aplikojë rregullimin përmes RAB-it (duke hequr mirëmbajtjen e kapitalizuar nga RAB).

Për ShTE5, KOSTT-i ka sqaruar paraprakisht se ka për qëllim të kapitalizojë një pjesë të mirëmbajtjes së lejuar. Për këtë arsye, ZRRE-së i është mundësuar të bëjë përshtatjet e duhura ex-ante. Duke e pranuar që shpenzimet e rinovimit janë kapitalizuar në mënyrën e duhur, ZRRE-ja zbritur këto të Hyra nga shpenzimet operative dhe i ka përfshirë ato në RAB. Vlerësimi i ZRRE-së për këto rinovime është bazuar në ndryshimin në mes të shpenzimeve operative të propozuara nga KOSTT-i për vitin 2011 dhe shpenzimeve të realizuara të vitit 2010.

ZRRE-ja thekson se, edhe pse ka zbatuar një qasje më praktike të rregullimit të këtyre kostove gjatë këtij viti, parimi dhe qëllimi ka qenë gjithmonë i njëjtë - të shmangët numërimi i dyfishtë dhe mbi-kompensimi.

Për ZRRE-në nuk është i qartë pohimi i KOSTT-it për vlerën prej 5.1 milionë eurosh si shpenzime kapitale për vitin 2009. Në atë vit, niveli i të Hyrave të Lejuara për shpenzime të mirëmbajtjes ka

Komentet e KOSTT-it

qenë vetëm 3.9 milionë euro, prej të cilave KOSTT-i ka raportuar të ketë shpenzuar vetëm 0.9 milionë euro, dhe pjesa tjetër është kapitalizuar.

Për këtë arsye, ZRRE-ja nuk propozon të bëjë ndonjë rregullim në të Hyrat e Lejuara të propozuara për KOSTT-in sa i përket mirëmbajtjes së kapitalizuar.

5.4 Kostot e personelit

Në Raportin Konsultativ, ZRRE-ja kishte propozuar që të mos pranojë kërkesën e KOSTT-it për rritjen e kostove të personelit në ShtE5. Për më tepër, ZRRE-ja kishte propozuar që kostot aktuale të personelit të KOSTT-it duhet të reduktohen për 10% për t'u afruar me nivelet e kostove të personelit me profile të ngjashme profesionale të punësuar në sektorin e energjisë së Kosovës.

KOSTT-i pretendon se nuk është e mundur të krahasohen shpenzimet e personelit të KOSTT-it me ato të sektorëve të tjerë për shkak se struktura e të punësuarve të stafit të KOSTT-it ndryshon në masë të konsiderueshme nga struktura e kompanive të tjera. KOSTT-i pretendon se 50% e personelit që ata punësojnë kanë kualifikime superiore, ndërsa për kompanitë tjera, të tilla si KEK-u, përqindja e të punësuarve me kualifikime të tilla është rreth 10%. KOSTT-i po ashtu ka krahasuar që raporti i shpenzimeve të personelit të tyre kundrejt të hyrave totale është më i ulëti në rajon me 16.5%. Përveç kësaj, KOSTT-i përmendur një pjesë të Metodologjisë Tarifore ku thuhet se ZRRE-ja nuk do të përfshihet në mikro-menaxhimin e KOSTT-it.

ZRRE-ja thekson se në propozimin e saj të dhënë në Raportin Konsultativ ka krahasuar kostot e personelit të KOSTT-it me kompanitë e profileve të krahasueshme të të punonjësve. ZRRE-ja pajtohet që KOSTT-i ka një arsye valide që të ketë kosto mesatare të personelit që janë më të larta se ato të KEK-ut, për shkak të profileve të ndryshme të punonjësve. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, që KOSTT-i duhet të ketë kosto mesatare të personelit më të larta se operatorët e tjerë me përgjegjësi të njëjta në rajon. Figura 2 më poshtë krahason kostot mesatare të personelit të KOSTT-it duke i krahasuar me OST-të e Republikës së Maqedonisë (MEPSO) dhe të Republikës së Shqipërisë (OST).




Figura 2: Krahasimi i kostove mesatare të personelit në mes të OSTT-ve të ndryshëm në rajon

Siç tregon figura, jo vetëm që kostot mesatare të personelit të KOSTT-it janë më të larta se ato të MEPSO-s ose OST-së në terma absolut, por ato janë gjithashtu më të larta në terma relativë krahasuar me pagat mesatare kombëtare të vendeve të tyre përkatëse. Treguesit e gjelbër janë indekse që krahasojnë raportin e kostove të personelit të Operatorit me pagat mesatare kombëtare. Në të tregohet se kostot e personelit të KOSTT-it janë rreth 3.5 herë më të mëdha se pagat mesatare nacionale, ndërsa ato të MEPSO-s dhe OST-it janë 2.5 dhe 3.15 respektivisht. Këto krahasime marrin parasysh vlerat e realizuara të shpenzimeve të personelit të KOSTT-it. Po të kishte aprovuar ZRRE-ja kërkesën e KOSTT-it për rritjen e shpenzimeve të personelit, ajo do të shkonte edhe më larg nga ato që do të ishin kosto të arsyeshme mesatare të personelit.

Për këtë arsye ZRRE-ja nuk do të ndryshojë qëndrimin e saj për kostot e personelit të dhënë në Raportin Konsultativ. Duke ndërhyrë në kostot e personelit, ZRRE-ja nuk është duke u përfshirë në çështjet e mikro-menaxhimit të KOSTT-it, për më tepër ajo është duke e përmbushur mandatin e saj për të lejuar kompanitë që të mbulojnë ato kosto që janë të arsyeshme.

5.5 Kostot e shërbimeve ndihmëse

Në propozimin e saj të dhënë në Raportin konsultativ, ZRRE-ja kishte deklaruar se do të lejojë që KOSTT-i të mbulojë 1.6 milionë euro për kostot e shërbimeve ndihmëse që është dashur t’ia paguajë KEK-ut, me kusht që KOSTT-i t’i japë ZRRE-së arsyetim shtesë të këtyre kostove para se ZRRE të japë vendimin përfundimtar për të Hyrat e Lejuara në kuadër të këtij shqyrtimi tarifor.

Në komentet e tij KOSTT-i argumenton se kostot e shërbimeve ndihmëse janë për shkak të EMS-së dhe do të kompensohen kundrejt kompensimit të përcaktuar ndër-OST. Megjithatë, në ShTE4, KOSTT-i kishte pretenduar se nuk do të paguajë EMS-në, por do të bëjnë kontratë me KEK-un për të njëjtën shumë.

Meqë KOSTT-i në fakt nuk e ka paguar KEK-un në vitin 2010 dhe nuk ka kontratë të nënshkruar me KEK-un për këtë lloj shërbimesh², ZRRE-ja propozon që të mos lejojë 1.6 milionë euro të kërkuara për shërbimet ndihmëse. Meqë gjenerimi i KEK-ut është dashur të jetë përfituesi i këtyre të Hyrave si të ardhura të parregulluara, ZRRE-ja do të rrisë të Hyrat e Lejuara të KEK-ut për të njëjtën shumë. Kjo do të rezultojë në një ulje prej 1.6 milionë eurosh në të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it, një shtesë e të njëjtës shumë në të Hyrat e Lejuara të KEK-ut, megjithatë efekti neto në tarifat mesatare është zero.

5.6 Shpenzimet tjera të përgjithshme

Në përgjigjet e tij, KOSTT-i ka dhënë arsyetimin për rritjet e mëdha të propozuara në shpenzimet e tjera të përgjithshme të përfshira në shpenzimet operative për vitin 2011. ZRRE-ja i pranon këto arsytetime, me përjashtim të kompensimit për shpronësime dhe dëme ndaj palëve të treta, të cilat ZRRE-ja do t'i kapitalizojë meqenëse janë shpenzime që kanë të bëjnë me një investim kapital.

ZRRE-ja propozon që të rrisë lejimin për shpenzimet e tjera të përgjithshme tek shpenzimet operative për 0.73 milionë euro, siç kërkohet nga KOSTT-i, dhe shpenzimit për Kompensimin e dëmeve të personave të tretë për 0.184 milionë euro të kapitalizohen te RAB-i.

5.7 Financimi i shpenzimeve kapitale

KOSTT-i ka komentuar se alokimet nga Buxheti i Republikës së Kosovës (BRK) për KOSTT-in në vitin 2011 do të jenë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e planifikuara kapitale. KOSTT-i nuk bën ndonjë propozim se si kjo mund të ndikojë në të Hyrat e lejuara dhe tarifat e KOSTT-it, por vetëm ia tërheq vëmendjen e ZRRE-së në këtë çështje.

ZRRE-ja thekson se KOSTT-i në vitet e mëparshme nuk ka arritur të përmbushë nivelet e planifikuara planifikuara të shpenzimeve kapitale për shkak të vonësive në fondet që alokohen nga BRK dhe në proceset e prokurimit. Duke pasur parasysh këtë, është e paqartë për ZRRE-në nëse KOSTT-i do të jetë në gjendje të bëjë shpenzimet e plota kapitale të planifikuara.

Poashtu, ZRRE-ja nuk ka mundur të barazojë informacionin e dhënë nga KOSTT për këtë mungesë potenciale të fondeve me atë të dhënë më parë për të mbështetur aplikacionin e tarifave. Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat për shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin 2011 dhënë nga KOSTT-i në kuadër të aplikacionit fillestar për tarifa, si dhe të dhënat e dorëzuara në përgjigjet e KOSTT-it për Raportin Konsultativ.

²ZRRE-ja e kupton që në mes të KEK-ut dhe KOSTT-it është diskutuar për një draft kontratë për sigurimin e shërbimeve ndihmëse, por ajo nuk është nënshkruar ende, dhe që KEK-u ka bërë të ditur se nuk e ka ndërmend ta nënshkruajë kontratën

Tabela 3: Investimet e KOSTT-it

Projektet	Alokimet BRK (€)	Planifikuar në 2011 (€)		Alokimet minus planifikimet (€)	
		Aplikacioni tarifor	Përgjigjet	Aplikacioni tarifor	Përgjigjet
SCADA/EMS & Telecom	1,524,050	600,800	2,370,237	923,250	(846,187)
Packet project 400/110kV – Peja 3	2,322,283	0	2,322,283	2,322,283	0
SS 400/110kV – Ferizaj 2	4,368,443	16,145,600	6,649,472	(11,777,157)	(2,281,029)
Gjithsejt	8,214,776	16,746,400	11,341,992	(8,531,624)	(3,127,216)

ZRRE-ja thekson se ka ndryshime shumë të mëdha në mes të shpenzimeve të planifikuara të treguara në kuadër të aplikacionit fillestar për tarifa dhe në përgjigjet e KOSTT-it. Këto ndryshime të mëdha e bëjnë të vështirë për ZRRE-në që të besojë projeksionet e KOSTT-it të shpenzimeve kapitale në vitin 2011 dhe, rrjedhimisht në ekzistencën ose përndryshe në deficitin e financimit. Përveç kësaj, ndryshimet e mëdha sugjerojnë që KOSTT-i ka aftësi të konsiderueshme për të vonuar ose për të ndaluar investimet kapitale kurdo që është e nevojshme. Duke pasur parasysh këtë, ZRRE-ja nuk propozon të bëjë ndonjë rregullim për të Hyrat e Lejuara si pasojë e këtij komenti të KOSTT-it.

6 Subvencionet e importit

Në Raportet e saj konsultative, ZRRE-ja ka supozuar se subvencionet e importit të paguara nga BRK-ja për vitin 2011 do të ishin 33.05 milionë euro, siç parashikohet në draftin e BRK-së të nxjerrë në tetor 2010. BRK-në i miratuar nga Kuvendi parashikon subvencione importi prej 27.3 milionë euro. Paralogaritja e të Hyrave të Lejuara që do të mblidhen prej tarifave të rregulluara me pakicë është rregulluar në mënyrën e duhur.

7 Përmbledhja e propozimeve

Si përmbledhje, ZRRE-ja ka bërë pesë rregullime në të Hyrat e Lejuara të propozuara në Raportet Konsultative të saj. Këtu bëjnë pjesë shtimi i kostove të sigurimit për Furnizimin e KEK-ut, heqja e kostove të shërbimeve ndihmëse nga të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it (dhe një rregullim korrespondues për të hyrat e lejuara të KEK-ut), rritja e shpenzimeve të tjera të përgjithshme për KOSTT-in në shumën e kërkuar fillimisht, reduktimi i subvencioneve të supozuara të importit për të reflektuar të dhënat më të reja të disponueshme dhe reduktimi i kostove të importit të pashpenzuar .

Të Hyrat e Lejuara të propozuara që do të mblidhen nga tarifat e rregulluara pas këtyre rregullimeve paraqiten më poshtë. Të Hyrat e përgjithshme të Lejuara arrijnë vlerën prej 180.3 milionë eurosh.

Tabela 4: Të Hyrat e Lejuara të propozuara nga tarifat e rregulluara me pakicë

TË HYRAT E LEJUARA		KEK				Gjithsej KEK	KOSTT-i	GJITHSEJ
		Minierat	Gjenerimi	Distribucioni	Furnizimi			
Shpenzimet Operative	€000s	42,244	30,802	16,714	19,217	108,976	5,339	114,315
Zhvlerësimi	€000s	8,899	4,912	1,143	439	15,392	2,059	17,451
Kthimi I Lejuar	€000s	22,152	6,663	3,308	1,421	33,544	1,302	34,846
Importi	€000s				50,114	50,114		50,114
Blerjet jashtë KEK-ut	€000s				3,971	3,971		3,971
Shërbimet Ndihmëse	€000s					0	0	0
Kostot e alokuara të AQ	€000s	5,551	2,639	1,945	1,926	12,061		12,061
Gjithsej kostot e lejuara	€000s	78,846	45,016	23,110	77,086	224,058	8,699	232,758
Shitjet ndaj konsumatorëve të kualifikuar	€000s				0	0		0
Eksporti	€000s				-4,467	-4,467		-4,467
Të Hyrat tjera operative	€000s	-1,500	0			-1,500		-1,500
Subvencionet	€000s				-27,350	-27,350		-27,350
Bashkërenditjet	€000s	-1,861	-2,074	-1,809	-13,345	-19,088	-25	-19,113
Gjithsej të Hyrat e Lejuara	€000s	75,485	42,942	21,301	31,925	171,653	8,674	180,328

Siç deklarohet në Raportet Konsultative, ZRRE-ja propozon që të mos bëjë ndonjë ndryshim në tarifat ekzistuese të rregulluara me pakicë për vitin 2011. Në bërjen e këtyre propozimeve, ZRRE-ja supozon se Ferronikeli furnizohet si konsumator i rregulluar sipas tarifës së propozuar më lart.

ZRRE-ja ka reduktuar ngarkesat e rregulluara të KOSTT-it për 33.5%, që paraqet ndryshimin në mes të të Hyrave të Lejuara të propozuara të ZRRE-së (duke përfshirë edhe kostot e humbjeve në transmision) dhe të Hyrat e parallogaritura në kuadër të ngarkesave të rregulluara të KOSTT-it të vitit 2010. Reduktimi i ngarkesave individuale mund të ndryshojë nga kjo mesatare, në varësi të alokimit të kostove përgjatë ngarkesave individuale.

Tabela 5: Të Hyrat e Lejuara të propozuara nga ngarkesat e rregulluara të transmisionit

Të hyrat e lejuara		SHTË 4 Aprovuara	Aplikacioni I KOSTT-it	Propozimi i ZRRE-së
Shpenzimet operative	€000s	7,847	7,409	5,339
Amortizimi	€000s	1,857	2,039	2,059
Kthimi I Lejuar	€000s	934	1,209	1,302
blerja e humbjeve	€000s	5,582	5,186	3,868
Shërbimet ndihmëse	€000s	1,624	1,600	0
Gjithsejt shpenzimet e lejuara	€000s	17,844	17,443	12,567
Përshtatjet	€000s	235	-25	-25
Gjithsej të hyrat e lejuara	€000s	18,080	17,418	12,542
Vëllimi në hyrje të transmisionit	GWh	4,309	4,523	4,496
Ngarkesat mesatare të kërkuara	€/kWh	0.42	0.39	0.28
Ngarkesat			-8.2%	-33.5%

Tarifat rezultuese të propozuara me pakicë për konsumatorët ekzistues të rregulluar dhe ngarkesat e rregulluara të KOSTT-it janë paraqitur në Shtojca 1: Tabelat e tarifave.

Përveç kësaj, një kufi i të Hyrave do të zbatohet për KOSTT-in në mënyrë që ndryshimet në mes të Hyrave të realizuara dhe atyre të lejuara në vitin 2011 të bashkërenditen në vitet pasuese.

Shtojca 1: Tabelat e tarifave

Shtojca 1: Tabelat e tarifave

Tarifat e rregulluara të KEK-ut

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Të miratuara	
					Sezoni i Lartë	Sezoni i ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 31 shtator
01	220kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		167.67	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		13.26	
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh		2.05	
02	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		83.83	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5.59	5.59
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.49	1.92
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.70	1.58
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.00	0.00		
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		11.08	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5.81	5.81
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.79	2.94
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.59	2.65
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.66	0.66		
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.58	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5.01	5.01
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.61	3.39
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.10	3.09
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.66	0.66		
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.58	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		2.91	2.91
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	8.45	4.69
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.33	4.43
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.66	0.66		
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.92	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifë e vetme	10.41	6.73
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	12.53	8.21
			€/kWh	Tarifë e Ulët	6.26	4.10
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.08	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	4.64	3.33
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.33	1.66
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.43	4.60
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.22	2.31
		>600 kWh/muaj (Blloku i Tretë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	9.33	6.68
€/kWh	Tarifë e Ulët	4.66	3.35			
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.08	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e vetme	4.14	2.96
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e vetme	5.73	4.10
		>600 kWh/muaj (Blloku i Tretë):	€/kWh	Tarifë e vetme	8.31	5.96
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar:				
		<200 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		21.50	
		200-600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		38.92	
		>600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		65.58	
8	Ndriçim publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.92	
		Energjia aktive (P) për konsum:	€/kWh	Tarifë e vetme	8.42	8.42

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.
Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me $\cos(\Phi)=0.95$

Shtojca 1: Tabelat e tarifave

Shtojca 2: Ngarkesat e KOSTT

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementi Tarifor	Njësia	Të tanishme	Të propozuara
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934	0.483
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018	0.015
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934	0.483
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018	0.015
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.287	0.108
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018	0.015
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	4.057	3.225
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934	0.483
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018	0.015
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	8.832	6.650
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934	0.483
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018	0.015